



UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE




# MANUAL UDHËZUES

## INVENTARI I MATJES SË INTERESAVE

### INVENTARI I GLOBIT PERSONAL

#### *PERSONAL GLOBE INVENTORY*

Përshtatur për kontekstin shqiptar  
SHTATOR, 2020



Mbështetur nga:



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për  
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC





UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE



## MANUAL UDHËZUES

# INVENTARI I MATJES SË INTERESAVE

## INVENTARI I GLOBIT PERSONAL *PERSONAL GLOBE INVENTORY*

Përshtatur për kontekstin shqiptar  
SHTATOR, 2020

Mbështetur nga:



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për  
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zviceriane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC



Autori i Personal Globe Inventory (PGI)

**Dr. Terence J.G. Tracey** (*Arizona State University, U.S.A., dhe University of British Columbia, Canada*)



Përshtatën për kontestin shqiptar testin PGI dhe përcaktuan karakteristikat psikometrike përkatëse, si edhe përgatitën në shqip Manualin Udhëzues të PGI-së.

**Dr. Livia Nano** (*Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës*)

**Dr. Eralda Zhilla** (*Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës*)

**Dr. Nada Kallçiu** (*Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës*)



Supervizim teknik gjatë procesit të kontekstualizim të PGI-së për kontekstin shqiptar

**Prof. Dr. Jerome Rossier** (*Universiteti i Lozanës -UNIL*)

Ky manual është përgatitur nga Dr. Livia Nano, Dr. Eralda Zhilla, Dr. Nada Kallçiu me mbështetjen e RisiAlbania. Pikëpamjet dhe opinionet që përmbahen në të nuk përfaqësojnë ato të Qeverisë Zvicerane, as të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.

**International Standard Book Number (ISBN) 978-9928-4564-4-1**

Manuali është kataloguar pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë



**Për çdo pyetje apo informacion të mëtejshëm kontaktoni:**

**Dr. Livia Nano:** [livia.nano@gmail.com](mailto:livia.nano@gmail.com)

**Dr. Eralda Zhilla:** [adazhilla@gmail.com](mailto:adazhilla@gmail.com)

**Dr. Nada Kallçiu:** [nkallciu@gmail.com](mailto:nkallciu@gmail.com)

# TABELA E PËRMBAJTJES

<b>1. Procesi i përshtatjes së instrumentit në kontekstin shqiptar</b>	<b>7</b>
<b>2. Si mund të përdoret PGI</b>	<b>8</b>
<b>3. Modeli PGI - Globi</b>	<b>9</b>
<b>4. Përshkrimi i testit dhe përmbledhja e analizës psikometrike</b>	<b>11</b>
<b>5. Prezantimi i profilin individual të PGI-së dhe hartimi i raporteve individuale</b>	<b>14</b>
<b>6. Si mund të përllogariten, lexohen dhe paraqiten grafikisht rezultatet e shkallëve të interesit</b>	<b>17</b>
<b>7. Referenca</b>	<b>19</b>
<b>Aneksë</b>	<b>21</b>
Aneksi 1: Përshkrimi i shkallëve të PGI-së	21
Aneksi 2: Inventari i Globit Personal (PGI)	23
Aneksi 3: Përllogaritja e shkallëve të PGI-së	26
Aneksi 4: Shembull	27

# INVENTARI I GLOBIT PERSONAL

## PERSONAL GLOBE INVENTORY (PGI)

Inventari i Globit Personal, ose shkurt PGI (Personal Globe Inventory), është hartuar nga Dr. Terence J.G. Tracey për të matur interesat e njerëzve në aktivitete të ndryshme si edhe që të ndihmojë individët t'i lidhin këto interesa me vendime të rëndësishme të jetës të tilla si: çfarë karrierë të zgjedhësh, apo çfarë dege studimi të zgjedhësh. Po ashtu, PGI mat dhe jep informacion në lidhje me hobet apo interesat e tjera (përtej interesit profesional) që individët mund të kenë dhe të motivohen prej tyre. Qëllimi i PGI-së është t'i japë individit një model mbi të cilin të mendojë në lidhje me interesat personale si edhe të krahasojë se si janë të ngjashme apo të ndryshme interesat individuale me ato të njerëzve të tjerë.

# 1

## PROCESI I PËRSHTATJES SË INSTRUMENTIT NË KONTEKSTIN SHQIPTAR

Inventari i interesave PGI (Personal Globe Inventory) është përshtatur në kontekstin shqiptar nga një grup ekspertësh, profesorë të Universitetit të Tiranës nën drejtimin dhe në bashkëpunim të ngushtë me ekipin e punës në Universitetin të Lozanës (UNIL) nën kujdesin e veçantë të Prof. Dr. Jerome Rossier. Gjithashtu, procesi është mbështetur dhe supervizuar nga autori i instrumentit Dr. Terence J.G. Tracey nga Arizona State University, U.S.A. dhe University of British Columbia, Kanada. Prosesi është zhvilluar në disa faza përgjatë një periudhe një vjeçare.

**Faza e parë** përkton me përkthimin në gjuhën shqipe të instrumentit, duke kaluar më pas në fazën e pilotimit në një kampion prej 20 të rinjsh nga ku është mbledhur feedback-u në lidhje me qartësinë e thënieve duke ndihmuar në riformulimin e pyetjeve specifike, pjesë e këtij instrumenti. Të gjitha komentet janë reflektuar dhe është bërë më pas përkthimi në mënyrë të pavarur në gjuhën angleze. Grupi i ekspertëve ka komunikuar me autorin duke pasqyruar të gjitha sugjerimet e të rinjve dhe duke siguruar në të njëjtën kohë ruajtjen e kuptimit origjinal për të gjitha pohimet.

Pas kësaj faze është rënë dakord lidhur me instrumentin që do përdoret në **fazën e dytë** me një kampion prej 200 personash në qytetin e Tiranës. Grupi i ekspertëve ka bërë një shpërndarje demografike të kampionit dhe ka administruar instrumentin te 200 të rinj. Pas analizës së qëndrueshmërisë së brendshme për këtë kampion është bërë përsëri rishikimi i disa pohimeve specifike me qëllim që të përmirësohet më tej instrumenti, duke bashkëpunuar ngushtë me autorin e inventarit të interesave. Gjatë kësaj faze është realizuar edhe procesi test-retest, ku 80 të rinj kanë plotësuar të njëjtin instrument dy herë me një diferencë kohore prej dy javësh. Në fund të kësaj faze është finalizuar instrumenti me të gjitha pyetjet që do të përdoren për fazën e tretë të procesit.

**Në fazën e tretë** instrumenti është administruar në një kampion rastësor përfaqësues prej 1258 personash, me një shtrirje gjeografike që përfshin pjesën veriore, qendrore dhe jugore të vendit, përkatësisht në: Shkodër, Lezhë, Tiranë, Fier, Vlorë, Berat dhe Korçë. Grupi i ekspertëve është kujdesur që kampioni të ishte divers jo vetëm përsa i përket shpërndarjes gjeografike, ndarjes rural-urban, por edhe përsa i përket gjinisë dhe moshës duke përfshirë të rinj nga 14 deri në 22 vjeç në disa cikle shkollimi (klasa e nëntë, shkollat e mesme të përgjithshme dhe profesionale, universiteti në ciklin bachelor). Pas mbledhjes dhe hedhjes së të dhënave të mbledhura u realizuan të gjitha analizat psikometrike përkatëse duke paraqitur, kështu, të atashuar në këtë manual, versionin në shqip të PGI-së të dakortësuar me autorin e instrumentit së bashku me mënyrën e pikëzimit dhe interpretimit.

**Faza e katërt** përkton me hartimin e manualit të përdorimit dhe trajnimin e profesionistëve, këshillues kariere, psikologë shkollorë që do e përdorin instrumentin në zyrat e karrierës pranë universiteteve, shkollave të mesme të përgjithshme dhe profesionale, zyrave të pushtetit lokal dhe/ose shërbimit psikosocial në shkollë.

# 2 SI MUND TË PËRDORËT PGI

PGI është shumë e ngjashme me situatën kur një person i drejton një individ një seri pyetjesh në lidhje me atë se çfarë i pëlqen të bëjë. Më pas përgjigjet të përmbliidhen në disa shkallë të thjeshta për t'u kuptuar, të cilat përfaqësojnë disa fusha kryesore interesi. Kjo procedurë ka për qëllim të ndihmojë individin të organizojë të menduarin e tij në lidhje me interesat që ka. Avanzazi i përdorimit të një instrumenti matës formal për interesat, siç është PGI, qëndron në faktin se interesat personale mund të krahasohen edhe me ato të të tjerëve. Informacioni që raportohet nga PGI mund t'i ndihmojë individët të mendojnë në lidhje me vendime të rëndësishme që marrin në jetë duke ofruar informacion në lidhje me:

- Çfarë karriere profesionale të zgjedhësh;
- Çfarë dege studimi të zgjedhësh në universitet;
- Sa ndryshe jam unë në raport me të tjerët nisur nga ajo që pëlqej;
- Mundësi të reja karriere të cilat nuk i kisha konsideruar më parë;
- Konfirmim i planeve aktuale në lidhje me karrierën profesionale;
- Identifikimi i interesave të tjera, përtej karrierës;
- Përzgjedhja e karrierës dhe e hobeve për t'u ndjerë më i lumtur.

Në përgjithësi, sa më tepër të përputhen karriera, fusha e studimit, apo aktivitetet jashtë punës me interesat e personit, aq më tepër gjasa ka që individ të ndjehet i kënaqur. Qëllimi i PGI është të ofrojë informacion mbi fushat e interesave, në mënyrë që individ të mund të zgjedhë ato fusha tek të cilat do të këtë më tepër gjasa të ndjehet i kënaqur. Pra, me fjalë të tjera, analiza e rezultateve të profilit të PGI mund të përdoret për të menduar dhe orientuar më mirë zgjedhjet që do të bëjë individ.

PGI nuk mat aftësitë aktuale të individit, por mat vetëm ato që i pëlqen të bëjë, si edhe aftësitë e vetëperceptuara (pra, perceptimin se sa i mirë je në kryerjen e një aktiviteti të caktuar). Pra, rezultatet nuk tregojnë se sa mirë do të performojë individ në aktivitete apo punë të ndryshme, por vetëm shkallën në të cilën ai mund ta pëlqejë kryerjen e tyre. PGI është mjaftueshëm i plotë për të dhënë një informacion të pasur mbi një gamë të madhe fushash interesi. Ka rreth 151 rezultate të ndara që mund të përlllogariten për një individ. Megjithatë, jo të gjitha shkallët janë të vlefshme për të gjithë ata që e plotësojnë testin, ashtu sikurse, edhe i gjithë informacioni i marrë mund të mos jetë relevant për të gjithë individët. Zakonisht, individëve u prezantohet vetëm informacioni më domethënës për ta. Raportimi i pikëve dhe interpretimi i tyre janë të orientuara në mënyrë individuale. Nuk ka dy individë të cilët të mund të kenë rezultate identike apo informacion të interpretueshëm në mënyrë identike. Testi ka për qëllim të japi informacion të vlefshëm për individët nga 14 deri në 30 vjeç të cilët janë në procesin e zgjedhjes së fushave të studimit apo profesioneve, si edhe për të verifikuar zgjedhjet e bëra.

Zakonisht, duhen rreth 20-30 min për të plotësuar PGI e rregullt. Ndërsa, për të plotësuar PGI-në versionin i shkurtër me 56 pohime, mund të duhen rreth 10-15 min. Çdokush mund ta plotësojë PGI-në, pra nuk ka kushte paraprake për ta plotësuar atë, por, më pas, për ta asistuar individin në interpretimin e rezultateve nevojitet një profesionist i kualifikuar/i trajnuar.



# 3 MODELI PGI GLOBI

Studimet kanë treguar se fushat kryesore të interesit mund të përfaqësohen si pika në sipërfaqen e një globi tre dimensional (shiko Fig.1), fushat e interesit më pranë njëra-tjetrës janë të ngjashme dhe ato më larg janë të ndryshme. Globi përcaktohet nga tri dimensione: Njerëz vs. Gjëra; Të dhëna vs. Ide dhe Prestigji i lartë vs. Prestigji i ulët. Pjesa më e rëndësishme e fushave të interesit janë ato që gjenden në ekuator dhe quhen Shkallët e Fushave të Interesit Bazë. Shembulli më i zakonshëm i shkallëve të interesit bazë janë gjashtë tipet e personalitetit të Holland (1997). Këto gjashtë tipe: **(Realist, Investigativ, Artistik, Social, Enterprising (Sipërmarrës) dhe Conventional (Konvencional)** shkurt **RIASEC**) janë të përfshirë thuajse në të gjithë inventarët që masin interesat, po ashtu edhe në PGI.




Fig.1 Tre dimensionet e Globit Personal

Modeli i globit mund të ndahet në seksione të ndryshme. Globi personal përdor tetë tipe në vend të gjashtë tipeve të Holland, pasi modeli me tetë shkallë është më lehtë i kuptueshëm se sa modeli me gjashtë shkallë të Holland. Në figurën në vijim (Fig. 2) është bërë një paraqitje vizuale dhe e integruar e gjashtë shkallëve të RIASEC (shkallët e Holland) dhe tetë shkallëve të PGI, si edhe dy dimensionet Njerëz-Gjëra dhe Të dhëna-Ide.

PGI përbëhet nga 18 shkallë që përbëjnë tre dimensione të interesit Njerëz-Gjëra; Të dhëna-Ide; dhe Prestigji. Paraqitja hapësinore e 18 shkallëve tregohet në Fig.3. Ndërsa në Aneksin 1 gjendet edhe një përshkrim i detajuar i të gjitha shkallëve të PGI. Pra, në mënyrë të përmbledhur, modeli i Globit Personal është një përfaqësim i përgjithshëm i interesave. Ai përmban në vetvete shumë shkallë dhe mund të ofrojë një informacion tërësor dhe të plotë të interesave të individit.




Fig 2: Rrethi i Interesave Bazë të Globit Personal





Fig 3. Një paraqitje vizuale e tetëmbëdhjetë shkallëve të PGI dhe e tre dimensioneve. Pjesa lart përfaqëson globin duke e parë nga poli i veriut (brenda tij ilustrohen edhe shkallët me prestigj të lartë) dhe pjesa poshtë përfaqëson globin duke e parë nga poli i jugut (brenda ilustrohen edhe shkallët me prestigj të ulët).

# 4 PËRSHKRIMI I TESTIT DHE PËRMBLEDHJA E ANALIZËS PSIKOMETRIKE

PGI përbëhet nga një listë aktivitetesh që lidhen me profesione të ndryshme për të cilat personi që plotëson testin jep përgjigje duke përcaktuar *nivelin e pëlqyeshmërisë/interesit* për këto aktivitete në një shkallë nga 1-7: 1=nuk më pëlqen fare dhe 7=më pëlqen shumë; si edhe duke përcaktuar nivelin e *perceptuar të aftësisë* në lidhje me këto aktivitete, po prapë në një shkallë nga 1-7, ku 1=aspak i aftë dhe 7=shumë i aftë.

Ka disa versione të testit PGI:

- PGI (versioni i rregullt me 113 aktivitete)
- PGI-i shkurtuar (version i shkurtuar me vetëm 40 aktivitete)
- PGI-mini (version krejt i shkurtër me vetëm 20 aktivitete)

PGI është përkthyer dhe përshtatur në shumë vende të botës. Ai është përshtatur edhe për kontekstin shqiptar.

Është përdorur një kampion rastësor përfaqësues në nivel vendi prej 1258 të rinjsh të grupmoshës 14-22 vjeç për të përcaktuar karakteristikat psikometrike të PGI-së, versioni në shqip. Qëndrueshmëria e brendshme: Në tabelën më poshtë paraqiten rezultatet e qëndrueshmërisë së brendshme për të 18 shkallët kryesore të PGI-së (me 113 pohime), të analizuar këto në mënyrë të veçantë për interesin, aftësitë dhe vlerën e përbërë.

- 18 shkallët kryesore të PGI-së që lidhen me Pëlqyeshmërinë/Interesin
- 18 shkallët kryesore të PGI-së që lidhen me Kompetencen/Aftësitë
- 18 shkallët kryesore të PGI-së që lidhen me vlerën e përbërë

Ashtu siç vihet re edhe nga tabela e dhënë më poshtë, për të gjitha shkallët kemi nivele të pranueshme dhe nivele të mira të *Cronbach Alpha*.

Besueshmëria në kohë: në tabelën më poshtë vihet re se instrumenti ka një stabilitet të mirë test-ritest për periudhën 2-javore. Testi i besueshmërisë në kohë është realizuar me një kampion prej 80 të rinjsh.

	PGI-versioni i rregullt	Qëndrueshmëria e brendshme Cronbach Alpha			Dy javë Test-retest**
		Interesi	Aftësia	Composite	Composite
	<b>Tetë shkallët e Interesit Bazë</b>				
1	Lehtësimi Social	0.73	0.745	0.74	0.74
2	Menaxhimi	0.70	0.75	0.74	0.73
3	Detaje biznesi	0.78	0.80	0.80	0.80
4	Procesim të dhënash	0.73	0.76	0.75	0.80
5	Mekanik	0.75	0.74	0.76	0.82
6	Natyrë/Jashtë	0.74	0.74	0.76	0.69
7	Artistik	0.79	0.78	0.80	0.75
8	Ndihmues	0.74	0.72	0.75	0.79
	<b>Pesë shkallët e Prestigjit të Lartë</b>				
9	Shkenca Sociale	0.79	0.78	0.80	0.70
10	Influenca	0.75	0.79	0.78	0.72
11	Sisteme të biznesit	0.80	0.84	0.83	0.69
12	Analizë Financiare	0.86	0.88	0.88	0.62
13	Shkenca	0.80	0.84	0.83	0.73
	<b>Pesë shkallët e Prestigjit të Ulët</b>				
14	Kontrolli i Cilësisë	0.69	0.73	0.73	0.82
15	Punë manuale	0.84	0.83	0.86	0.79
16	Shërbime personale	0.70	0.73	0.73	0.79
17	Ndërtim/Riparim	0.83	0.84	0.86	0.80
18	Shërbime bazë	0.71	0.70	0.71	0.76

\*N=1258 (grupmosha 14-22 vjeç)

\*\*N=80 (studente)

Vlefshmëria strukturore: vlefshmëria strukturore u ekzaminua në lidhje me mënyrën se si ajo ndryshonte sipas moshës, gjinisë dhe statusit socio-ekonomik në përputhshmëri me modelin qarkor. Analiza tregoi se rezultatet për PGI në shqip, në përgjithësi janë të krahasueshme me rezultatet e përfuara në SHBA si edhe në vendet e tjera ku PGI është përshtatur.

Normat: PGI është normuar duke përdorur një kampion rastësor prej 1258 të rinjsh. Megjithëse kampioni është divers dhe përfaqësues në shumë aspekte të tilla si: shpërndarja gjeografike në nivel vendi, gjinia, grupmosha 14-22 vjeç (mesatare=17 vjeç, SD=1.9), niveli i shkollimit (klasa IX-XII dhe viti 1-3 universitet, shkolla të mesme të përgjithshme dhe profesionale, zonë rurale dhe urbane), duhet mbajtur parasysh fakti që normat mund të jenë më të përshtatshme për të rinj të cilët kanë një lloj interesi/shqetësimi mbi karrierën e tyre profesionale (pra kryesisht nxënës gjimnazi dhe studentë universiteti), por nuk ka përfshirë ata individë që janë aktualisht në punë apo ata që janë pa punë dhe synojnë pozicione të reja pune. Instrumenti i raporton të gjitha vlerat në T-score (Mesatare=50 dhe Devijim Standard=10) në raport me normat e grupit në total dhe në raport me normat e grupit me gjini të njëjtë.

Në kontekstin shqiptar, për të përdorur një version të shkurtuar të PGI, bazuar edhe në të gjitha analizat psikometrike të realizuara - përfshirë këtu edhe analiza të veçanta psikometrike për PGI me 40 pohime - mund të përdoret versioni PGI me 56 pohime, i cili është një kombinim i shkallëve të PGI me 113 pohime dhe PGI me 40 pohime. Më konkretisht, te PGI me 56 pohime:

- tetë shkallët e para, që përkojnë me 8 shkallët e interesit bazë, janë bazuar në 8 shkallët e PGI me 113 pohime – ku secila prej shkallëve ka 6 pohime.
- dy shkallët e tjera që kanë të bëjnë me Prestigjin e Ulët dhe Prestigjin e Lartë janë bazuar në PGI me 40 pohime, ku secila prej shkallëve ka 4 pohime<sup>1</sup>.

*Shiko Aneksin 2 – për versionin në shqip të inventarit të interesave PGI me 56 pohime.*

PGI me 56 pohime ka gjithësej 23 shkallë të paraqitura më poshtë. Diferenca me PGI me 113 pohime qëndron në faktin se, në këtë të fundit, Prestigji i Lartë përbëhet nga pesë nënshkallë dhe Prestigji i Ulët nga pesë nënshkallë, ndërsa në versionin e PGI me 56 pohime këto shkallë janë shkurtuar dhe Prestigji i Lartë dhe Prestigji i Ulët përfaqësohen vetëm nga një shkallë secili.

- |                          |                    |                               |
|--------------------------|--------------------|-------------------------------|
| • Lehtësimi social       | • Prestigji i Ulët | • Enterprising (Sipërmarrës)  |
| • Menaxhimi              | • Njerëz           | • Conventional (Konvencional) |
| • Detajet e biznesit     | • Gjëra            | • Njerëz/Gjëra                |
| • Procesimi i të dhënave | • Të dhëna         | • Ide/Të dhëna                |
| • Mekanik                | • Ide              | • Prestigji                   |
| • Natyra/Jashtë          | • Realist          |                               |
| • Artistik               | • Investigativ     |                               |
| • Ndihmues               | • Artistik         |                               |
| • Prestigji i Lartë      | • Social           |                               |

Për një përshkrim më të detajuar të secilës prej shkallëve të mësipërme shiko Aneksin 1.

Për PGI me 56 pohime mund të nxirren deri në 81 rezultate për çdo person që e plotëson atë:

- tetë shkallë të interesit bazë dhe prestigji i lartë/ prestigji i ulët (pëlqyeshmëria dhe aftësitë të kombinuara, pra vlera të përbëra) të nxjerra duke përdorur normat e kampionit të përgjithshëm dhe normat e së njëjtës gjini;
- tetë shkallë të interesit bazë dhe prestigji i lartë /prestigji i ulët te përgjigjet që lidhen me Pëlqyeshmërinë/Interesat;
- tetë shkallë të interesit bazë dhe Prestigji i lartë/ Prestigji i ulët te përgjigjet që lidhen me Kompetencën/Aftësitë;
- tetë shkallë të interesit bazë dhe Prestigji i lartë/ Prestigji i ulët (pëlqyeshmëria dhe aftësitë të kombinuara) vlera bruto;
- Katër shkallët e përgjithshme: Njerëz, Gjëra, Të dhëna dhe Ide (duke përdorur normat e kampionit të përgjithshëm dhe normat e gjinisë së njëjtë);
- Vlerat për 6 shkallët RIASEC të Holland (duke përdorur normat e kampionit të përgjithshëm dhe normat e gjinisë së njëjtë);
- Vlerat dimensionale të globit: njerëz vs. gjëra; të dhëna vs. ide dhe prestigji (duke përdorur normat e kampionit të përgjithshëm dhe normat e gjinisë së njëjtë);
- Diferenca midis vlerave të pëlqyeshmërisë dhe vlerave të kompetencës/aftësisë (duke përdorur normat e kampionit të përgjithshëm dhe normat e gjinisë së njëjtë);
- Shkallët e vlefshmërisë (pëlqyeshmëria, aftësitë, diferenca).

Megjithatë, ashtu siç u përmend edhe më lart, jo të gjitha rezultatet janë të vlefshme për të gjithë ata që e plotësojnë testin. Zakonisht, individëve u prezantohet vetëm informacioni më domethënës për ta. Në kapitullin në vijim do të ndalemi më në detaje tek aspektet që lidhen me paraqitjen e profilit individual të personit që plotëson PGI.

1. Rezultatet e qëndrueshmërisë së brendshme të PGI së shkurtuar (me 40 pohime) për të *Prestigjin e Lartë* janë përkatësisht (interesi alpha=0.68, aftësia alpha=0.73 composite alpha=0.72) dhe për *Prestigjin e Ulët* (interesi alpha=0.75, aftësia alpha=0.76 composite alpha=0.79).

# 5 PREZANTIMI I PROFILIT INDIVIDUAL TË PGI DHE HARTIMI I RAPORTEVE INDIVIDUALE

Ka të paktën tre mënyra në të cilat mund të prezantohet profili i individit që plotëson PGI:

- **Së pari**, në lidhje me fushat bazë të interesave;
- **Së dyti**, në lidhje me qasjen e tij ndaj shkallëve të interesit me prestigj të lartë apo shkallëve të interesit me prestigj të ulët;
- **Së treti**, në lidhje me ngjashmërinë midis aktiviteteve që individit pëlqen dhe perceptimin që ai ka sesa i aftë ndjehet në raport me to.

## 1. Shkallët e Fushave të Interesit Bazë

Grupi më i rëndësishëm i fushave të interesit janë ato që bien në ekuator dhe ky grup quhet Shkallët e Fushave të Interesit Bazë, të cilat formojnë bazën e interpretimit të PGI. Ekuatori i interesave mund të përfaqësohet ndryshe si katër, gjashtë apo tetë fusha të ndryshme interesi. Në varësi të mënyrës se si individit i përgjigjet instrumentit (*p.sh. sa më të ndryshme të jenë konsideruar pohimet e instrumentit, aq më i madh do të jetë numri i fushave të interesit që raportohen*), ai mund të marrë rezultate për katër shkallë, gjashtë shkallë ose tetë shkallë të ndryshme të Fushave të Interesit Bazë.

Në rast se individit që plotëson pyetësozin nuk u është përgjigjur me shumë diversitet pyetjeve të tij, atëherë ai mund t'i marrë rezultatet të organizuara sipas katër shkallëve; kurse, nëse ka diferencë të madhe në terma të pëlqyeshmërisë së aktiviteteve të ndryshme, atëherë individit do t'i marrë rezultatet e organizuara sipas tetë shkallëve. Zakonisht, pjesa më e madhe e individëve do t'i marrin rezultatet për tetë fushat bazë të interesit.

Pra, është e rëndësishme të mbahet parasysh se numri i shkallëve për të cilat do të marrë rezultate personi që e ka plotësuar PGI varet nga diferenca në mënyrën se si ai i është përgjigjur pohimeve të pyetësozit.

Shkallët që raportohen në **katër** fusha interesi janë:

- **Njerëz:** fokusohet në pëlqyeshmërinë për të patur rrotull njerëz;
- **Të dhëna:** fokusohet në aktivitete të detajuara;
- **Gjëra:** fokusohet në të punuarin me duar dhe për gjëra fizike;
- **Idë:** fokusohet në preferencën për të menduar në lidhje me gjërat.

Shkallët që raportohen në **gjashtë** fusha interesi janë **RIASEC**:

- **Realist**: parapëlqim për të bërë punë manuale dhe në ambient të hapur;
- **Investigativë**: parapëlqim për aktivitete shkencore;
- **Artistik**: parapëlqim për aktivitete krijuese dhe shprehëse;
- **Sociale**: parapëlqim për të punuar me të tjerët;
- **Enterprising** (Sipërmarrës): parapëlqim për aktivitete biznesi;
- **Conventional** (Konvencional): parapëlqim për detaje dhe aktivitete zyre.

Shkallët që raportohen në **tetë** fushat e interesit janë:

- **Lehtësimi social**: fokusohet në parapëlqimin për të punuar me të tjerët;
- **Menaxhimi**: fokusohet në parapëlqimin për aspekte të ndryshme të drejtimit të një biznesi;
- **Detaje biznesi**: fokusohet në detaje dhe aktivitete zyre në biznes;
- **Procesim të dhënash**: fokusohet në aspekte të menaxhimit të detajeve dhe informacionit;
- **Mekanikë**: fokusohet në parapëlqimin për të kuptuar dhe punuar me makineri;
- **Natyra/Jashtë**: fokusohet në parapëlqimin për të punuar dhe për të qenë jashtë;
- **Ndihma**: fokusohet në parapëlqimin për të ndihmuar të tjerët në mënyra të ndryshme.

Shikoni Fig.2 më lart për një përfaqësim vizual të rrethit të Interesave Bazë (me 4 shkallë, me 6 shkallë dhe me 8 shkallë).

## 2. Rëndësia e Prestigjit

Duke vijuar më tej me përshkrimin e shkallëve të interesit në Glob, aksi midis veriut dhe jugut përfaqëson rëndësinë që ka prestigji në gjërat që bën individ. Prestigji përfaqëson nivelin e përgjithshëm të vështirësisë, trajnimit, njohurive dhe shkollimit që kërkohet për aktivitete të ndryshme. Disa njerëz pëlqejnë shumë aktivitetet që kërkojnë shkollim dhe trajnim të gjatë. Disa të tjerë pëlqejnë aktivitetet që janë më të lehta për t'u mësuar dhe kërkojnë më pak trajnim. Ka disa fusha të ndryshme interesi të cilat bien në hemisferën veriore të Globit të PGI që reflektojnë prestigj të lartë dhe shume fusha të tjera të cilat bien në hemisferën jugore dhe reflektojnë prestigj të ulët.

Nëse rezultatet e individit në PGI tregojnë një model apo prirje për fushat e interesit me prestigj të lartë ose për fushat e interesit me prestigj të ulët, atëherë këto shkallë raportohen dhe interpretohen. Për shembull, nëse një person që ka plotësuar PGI ka preferencë për aktivitetet me prestigj të ulët, atij do t'i jepen rezultatet dhe grafiku që ka të bëjë me fushat e interesit me prestigj të ulët. Nëse një person që ka plotësuar PGI ka preferencë për aktivitetet me prestigj të lartë, atij do t'i jepen rezultatet dhe grafiku që ka të bëjë me fushat e interesit me prestigj të lartë. Nëse dikush nuk paraqet ndonjë tendencë as për njërën, as për tjetrën, rezultatet dhe interpretimi për këto shkallë nuk do të ofrohen.

Shkallët e interesit me **prestigj të ulët** tek PGI me 113 pohime:

- **Kontrolli i cilësisë**: fokusohet në kontrollin e detajeve;
- **Punë manuale**: foksuohet në të punuarin me duar apo me makineri;
- **Shërbime personale**: foksuohet në punën me njerëz për ndërveprime të përditshme;
- **Ndërtim/Riparim**: fokusohet në punën me makineri për të ndërtuar dhe riparuar;
- **Shërbimet bazë**: fokusohet në shitjen e produkteve dhe shërbimeve.

Shkallët e interesit me **prestigj të lartë** tek PGI me 113 pohime:

- **Shkenca sociale:** fokusohet në ndihmën psikologjike dhe mjekësore;
- **Influenca:** fokusohet në drejtimin dhe orientimin e të tjerëve;
- **Sistemet e biznesit:** fokusohet në aplikimin e njohurive për të drejtuar një biznes;
- **Analiza financiare:** fokusohet në ndihmën për të tjerët përsa i përket çështjeve financiare;
- **Shkenca:** fokusohet në një interesim të përgjithshëm për shkencën.

Kurse në rastin e PGI (me 56 pohime) raportimi dhe interpretimi i prestigjit është më i përmbledhur, pasi prestigji i lartë dhe prestigji i ulët përfaqësohen vetëm nga një shkallë e vetme për secilën (shiko Aneksin 2 – PGI me 56 pohime). Këto dy vlera krahasohen dhe raportohen nëse kanë diferencë të konsiderueshme mes tyre.

- **Prestigji i lartë**
- **Prestigji i ulët**

### **3. Mospërputhja midis pëlqyeshmërisë së aktiviteteve dhe aftësisë së perceptuar në lidhje me to**

Kur plotësohet PGI, individi pyetet sa i pëlqen aktiviteti dhe sa i aftë ndjehet ai/ajo në lidhje me aktivitetin përkatës. Vetëm nëse ka diferencë të konsiderueshme midis të dyjave (pra midis asaj se çfarë të pëlqen dhe çfarë ndjen se je i aftë) atëherë raportohen rezultatet për fushat e Interesit Bazë, për pëlqyeshmërinë dhe aftësinë e perceptuar në veçanti (shiko Fig.6 për një ilustrim). Duke analizuar se si përputhen apo jo pëlqyeshmëria me aftësinë e perceptuar në fushat e interesit bazë, individi mëson më shumë për veten e tij dhe mund ta përfshijë këtë informacion në procesin e vendimarrjes. Për shembull, nëse një person pëlqen aktivitetet artistike, por nuk ndjehet kompetent në këto aktivitete, mund të mendojë: ose për t'u regjistruar në kurse apo trajnime që mund ta ndihmojnë të përmirësojë shprehitë, ose, nëse një karrierë në arte do të ishte apo jo e përshtatshme për personin. Nëse individi vendos se nuk i ka shprehitë e nevojshme për të ndjekur një karrierë në arte, rezultatet e larta të pëlqyeshmërisë tregojnë se ai ndjen kënaqësi kur përfshihet në aktivitete artistike më shumë si hobi se sa si një karrierë më vete.

Nëse gjërat që individi pëlqen janë të ngjashme me ato për të cilat ndjehet i aftë, atëherë nuk është e nevojshme të paraqiten rezultate të ndara për pëlqyeshmërinë dhe aftësinë.



# 6

## SI MUND TË PËRLLOGARITEN, LEXOHEN DHE PARAQITEN GRAFIKISHT REZULTATET E SHKALLËVE TË INTERESIT

Shkallët e PGI-së me 56 pohime përbëhen nga gjashtë pohime dhe nga vetëm dy shkallë me katër pohime. Për secilin prej llojeve të pohimeve jepet informacion për: interesat/pëlqyeshmërinë dhe aftësinë e perceptuar. Në Aneksin 3 gjendet një informacion i detajuar në lidhje me mënyrën se si përllogariten shkallët e PGI-së me 56 pohime. Duke u bazuar në norma, është hartuar edhe një program kompjuterik i cili ndihmon në përllogaritjen e rezultateve. Raportimi i pikëve dhe interpretimi i tyre janë të orientuara në mënyrë individuale. Çdokush mund ta plotësojë PGI-në (versionin online apo atë në letër), por pastaj nevojitet një profesionist i kualifikuar/i trajnuar për të asistuar individin me interpretimin e rezultateve. Një mënyrë interpretimi është duke raportuar vlerën e përbërë të normuar (composite) që jepet nëpërmjet vlerës-T; vlerat e normuara mund të raportohen edhe në veçanti për interesat dhe aftësitë. Rezultati i vlerave të normuara (i vlerës-T) varion nga 20 në 80, me një mesatare 50. Pjesa më e madhe e njerëzve (përafërsisht rreth 65%-70%) kanë rezultate që bien midis 40-60 dhe këto rezultate konsiderohen si mesatare. Rezultatet më të mëdha se 60 konsiderohen të larta dhe tregojnë se rezultatet e fushës së interesit janë më të larta se pjesa më e madhe e njerëzve dhe se kjo fushë interesi është shumë e rëndësishme për personin. Rezultatet poshtë 40, konsiderohen të ulëta dhe tregojnë se individit është më pak i interesuar në këtë fushë se sa janë pjesa më e madhe e njerëzve të tjerë. Fushat e interesit me vlera/rezultate të ulëta janë ato për të cilat personi nuk paraqet preferencë. Rekomandohet që të fokusohemi tek rezultatet më të larta, sepse këto janë fushat në të cilat individit shpreh më shumë interes. Disa individë nuk kanë fusha interesi me vlerë të lartë dhe disa mund të kenë vetëm vlera të ulëta interesi. Vlerat e ulëta reflektojnë një mungesë interesi në një sërë aktivitetesh dhe kjo nuk është e pazakontë, sidomos për ata që janë nën moshën 19 vjeç. Në këtë rast, është mirë të fokusohemi në shkallën që paraqet vlerën më të lartë, sepse kjo tregon edhe preferencën më të madhe.

### **Paraqitja me grafikë rrethorë e Fushave të Interesit Bazë**

Fushat e Interesit Bazë paraqiten me një rreth; fushat më të ngjashme janë më pranë. Në përgjithësi, rezultatet në shkallët e fushave të interesit bazë që janë pranë njëra-tjetrës janë më të ngjashme se sa rezultatet e shkallëve që janë në anën e kundërt të rrethit. Rrethi ka për qëllim të na ndihmojë për të organizuar interesat. Është mirë të fokusohemi tek pjesët e rrethit që kanë vlerat më të larta. Grafiku i rezultateve të Fushave të Interesave Bazë duhet si një rrjetë merimange. Rezultatet më të larta janë më larg nga qendra dhe rezultatet më të ulëta janë më pranë me qendrën (shiko Fig.4 për paraqitjen grafike të 8 shkallëve të interesit bazë dhe Fig.5 për paraqitjen grafike të 4 shkallëve të interesit bazë). Në paraqitjen grafike është edhe një vijë që quhet vektor. Vektori fillon në qendër të rrethit dhe drejtohet drejt këndit të rrethit. Vektori është një përmbledhje e shpejtë e të gjithë rezultateve të fushave të Interesit Bazë. Ai tregon drejtimin e interesit të përgjithshëm si edhe forcën e këtij interesi. Për shembull, një vektor që është i drejtuar nga fusha e Menaxhimit tregon se kjo është fusha kryesore e interesit. Distanca nga qendra tregon forcën e parapëlqimit. Ashtu siç u përmend edhe më lart, vlerat midis 40-60 janë mesatare, nën 40 konsiderohen të ulëta dhe mbi 60 konsiderohen të larta. Pra, një vektor me vlerë 70 nënkupton një interes të fortë për fushën e Menaxhimit.




Fig.4 Grafiku me tetë shkallët bazë të interesit




Fig.5




Fig.6 Paraqitja grafike e mospërputhjes midis pëlqyeshmërisë së aktiviteteve dhe aftësisë së perceptuar në lidhje to

## 7 REFERENCA

### Për manualin janë përdorur burimet e mëposhtme:

- Tracey, T.J.G. (2019) Personal Globe Inventory: PGI, PGI-short, PGI-Mini. Manual Version 1.5. <https://pgi.asu.edu/technical>
- Tracey, T.J. G. Personal Globe Inventory: Interpretive Report. <https://pgi.asu.edu/technical>

8

ANEKSE



# ANEKSI 1

## PËRSHKRIMI I SHKALLËVE TË PGI-SË SË RREGULLT

### 18 shkallët sferike të Inventarit të Globit Personal (PGI)

---

#### 8 Shkallët e Interesit Bazë

- 1. Lehtësimi social:** Kjo shkallë mat parapëlqimin për të punuar me të tjerët duke shitur, asistuar, duke ofruar informacione apo duke administruar shërbime të tilla. Disa profesione që lidhen me këtë fushë janë: Drejtor i shërbimit social, Drejtor personeli, Drejtor publiciteti, Agjent shitjeje, Agjent udhëtimeve dhe Instruktor aerobie.
- 2. Menaxhimi:** Kjo shkallë mat parapëlqimin në menaxhimin dhe planifikimin e aktiviteteve kryesore të një organizate apo biznesi. Shkalla përfshin aktivitete të tilla si: procesim informacioni, zgjidhje problemesh dhe marrje vendimesh, parashikim dhe planifikim, komunikim me të tjerët, organizim dhe koordinim, supervizionim, si edhe nxitje e të tjerëve. Disa shembuj profesionesh që përfshihen në këtë shkallë janë: Menaxher zyre, Menaxher departamenti në një qendër tregtare, Menaxher hoteli.
- 3. Detaje biznesi:** Parapëlqimi për përllogaritje, vlerësime, buxhetime është ajo që karakterizon njerëzit që kanë vlera të larta të kësaj shkalle. Shembuj profesionesh që lidhen më të janë: Analist financiar, Punonjës në bankë, Vlerësues i kostove, Ekonomist etj.
- 4. Procesim të dhënash:** Karakterizohen nga një interes për përdorimin e matematikës dhe sistemeve që lidhen me analizën dhe interpretimin e të dhënave si edhe me qartësimin dhe zgjidhjen e problemeve teknike. Shembuj profesionesh të kësaj shkalle janë: Inxhinier elektrik, Programues kompjuterik, Teknik mikroelektronik.
- 5. Mekanik:** Fokusi kryesor i kësaj shkalle është të kuptuarit se si punojnë makineritë si edhe dizënjimi, instalimi dhe mirëmbajtja e makinerive. Shembuj profesionesh që përfshihen në këtë shkallë janë: Mekanik aeroplanësh, Auto-mekanik, Inxhinier kimist, Makinist etj.
- 6. Natyra/Jashtë:** Fokuset në parapëlqimin për të punuar dhe për të qenë jashtë, në natyrë duke aplikuar njohuritë e shkencës së jetës tek bimët dhe kafshët. Shembuj profesionesh në këtë shkallë janë: Ekologjist, Natyralist, Specialist pyjesh, Veteriner.
- 7. Artistik:** Kjo shkallë mat interesin në artet vizuale, në performancë dhe letërsi dhe shprehet kryesisht në profesione të tilla si: Skulptor, Muzikant, Kompozitor, Poet, Dramaturg, Autor.
- 8. Ndhim:** Kjo shkallë mat interesin për t'u përfshirë në marrëdhënie ndihmuese me njerëz të grupeve të ndryshme. Individët parapëlqejnë kryesisht të mësojnë të tjerët, të ofrojnë mbështetje dhe këshillim për të tjerët. Disa shembuj profesionesh që përfshihen në këtë shkallë janë: Terapist të foluri, Psikolog shkollor, Punonjës social, Edukator, Terapist familjeje.

#### Prestigj i lartë

- 9. Shkenca sociale:** Ofrimi i ndihmës për të tjerët për të zgjidhur probleme mjekësore apo psikologjike është lloji i aktivitetit që lidhen me profesione të tilla si Psikolog klinik, Psikiatër, Peditër, Mjek familje.
- 10. Influenca:** Kjo shkallë mat interesin në udhëheqjen dhe drejtimin e njerëzve në biznes, politikë dhe shkencë. Profesione të tilla si Drejtor i kërkimit shkencor, Kërkues shkencor, Kirurg, Fizikant, Astronom.
- 11. Sistemet e biznesit:** Shkrimi dhe hartimi i programeve apo sistemeve dhe apikimi i kësaj njohurie në biznes dhe financë është fokusi kryesor i kësaj shkalle. Shembuj profesionesh janë: Specialist kompjuterik në biznes, Programues biznesi, Analist sistemi, Konsulent kompjuterik.

12. Analiza financiare: Njerëzit në këtë shkallë punojnë direkt me klientët në lidhje me financat e tyre. Shembuj profesioneesh janë: Këshillues buxheti, Analist menaxhimi biznesi, Analist i tregut, Analist i investimeve personale, Drejtor i çështjeve të konsumatorit, Agjent burse.
13. Shkenca: Studimi i dukurive, realizimi i kërkimeve, zhvillimi i njohurive në shkencat biologjike, fizikë dhe shkencat e sjelljes janë fushat kryesore që maten nga kjo shkallë. Shembuj profesioneesh janë: Biolog, Antropolog, Shkencëtar i tokës, Gjeolog, Kimist.

#### **Prestigj i ulët**

14. **Kontrolli i cilësisë:** Kontrolli dhe mbrojtja e cilësisë dhe sigurisë së produkteve, materialeve dhe shërbimeve është fokusi i interesit të atyre njerëzve që marrin vlera të larta në këtë shkallë. Shembuj profesioneesh janë: Bravandreqës, Inspektor urash, Inspektor ndërtimi.
15. **Punë manuale:** Shfaqet interes për të punuar me makineri, vegla, apo shërbime mbështetëse. Këto profesione kërkojnë një trajnim minimal dhe shembuj profesioneesh të tilla janë: Punëtoreshërbimi, Pastrues xhamash, Shofer autobuzi.
16. **Shërbime personale:** Shfaqet interes për aktivitete që ofrojnë ndihmë për njerëzit në lidhje me veprimtaritë e përditshme. Njerëzve që marrin vlera të larta në këtë shkallë u pëlqen t'u shërbejnë të tjerëve ushqim, t'u japin atyre informacion, t'i ndihmojnë ata të blejnë rroba etj. Shembuj profesioneesh janë: Stjuardesë, Kamarier, Guidë udhëtimi.
17. **Ndërtim/Riparim:** Shfaqet interes për të punuar jashtë, për të punuar me duar për të ndërtuar struktura dhe për të përdorur apo riparuar makineri. Shembuj profesioneesh: Drejtues buldozeri, Drejtues vinçi, Prerës pemësh, Punonjës ndërtimi.
18. **Shërbimet bazë:** Shkalla mat interesin në shitjen e produkteve dhe shërbimeve, në mirëpritjen e njerëzve, në bërjen e rezervimeve, në marrjen me qira apo edhe pastrimin. Njerëzit që marrin vlera të larta në këtë shkallë zakonisht punojnë në kontakt të drejtpërdrejtë me klientët dhe përfshijnë profesione të tilla si: Receptonist, Stilist flokësh, Postier, Eskortë, Sekretare.

#### **6 Shkallët e Interesit bazë**

19. **Realist:** Parapëlqim për të punuar me duar dhe me objekte. Profesionet që përfshihen këtu janë: marangozë dhe inxhinierë që hartojnë dhe supervizionojnë ndërtimin e veprave të ndryshme.
20. **Investigativ:** Parapëlqim për punuar me ide dhe për të zbuluar se si funksionojnë gjërat. Shembuj profesioneesh janë: matematicienët, shkencëtarët.
21. **Artistik:** Parapëlqejnë të punojnë me ide, por nëpërmjet shprehjes artistike. Shembuj profesioneesh janë: piktorët, kërcimtarët/balerinët, shkrimtarët.
22. **Sociale:** Parapëlqim për të punuar dhe ndihmuar të tjerët. Profesionet që përfshihen këtu janë: mësues dhe punonjës social.
23. **Enterprising** (Sipërmarrës): Parapëlqim për të punuar me të tjerët, por nëpërmjet nxitjes dhe shitjes. Shembuj profesioneesh janë: shitës dhe menaxher.
24. **Conventional** (Konvencional): Parapëlqim për aktivitete rutinë dhe të strukturuar. Shembuj profesioneesh përfshijnë: llogaritar, ekonomist, punonjës në bankë.

#### **4 Shkallët e Interesit Bazë**

25. **Njerëz:** fokusohet në pëlqyeshmërinë për të patur rrotull njerëz;
26. **Të dhëna:** fokusohet në aktivitete të detajuara;
27. **Gjëra:** fokusohet në të punuarin me duar dhe për gjëra fizike;
28. **Idetë:** fokusohet në preferencën për të menduar më lidhje me gjërat.

#### **Shkallët tre dimensionale**

29. **Njerëz/Gjëra**
30. **Të dhëna/Ide**
31. **Prestigj**

## ANEKSI 2

### INVENTARI I GLOBIT PERSONAL (PGI)

(me 56 pohime)

Ju lutem shihni më poshtë listën e aktiviteteve dhe përgjigjuni për secilin dy herë. Një herë duke treguar sa ju pëlqen aktiviteti përkatës dhe njëherë, sa aftësi ndjeni se keni, për ta realizuar këtë aktivitet. Për të vlerësuar aktivitetet përdorni shkallën e mëposhtme:

Pëlqyeshmëria/Interesi						
1	2	3	4	5	6	7
Nuk më pëlqen aspak			Neutral			Më pëlqen shumë

Aftësitë/Kompetencat						
1	2	3	4	5	6	7
Aspak i aftë			I aftë në mënyrë të moderuar			Shumë i aftë

Interesi/ Pëlqyeshmëria	Aftësitë	
		1. Mirëpres njerëzit kur hyjnë në një biznes (në recepsion)
		2. Menaxhoj/administroj një hotel
		3. Përgatis raporte financiare
		4. Menaxhoj/kontrolloj një grup njerëzish që merren me përpunim të dhënash (p.sh. shifrash dhe informacione të tjera).
		5. Instaloi një rrjet elektrik
		6. Klasifikoj llojet e ndryshme të kafshëve të egra
		7. Shkruaj poezi
		8. Ndhimoj të tjerët
		9. Shoqëroj klientët për t'u ulur në restorant
		10. Shes produkte të ndryshme
		11. Vlerësoj shumën e nevojshme që parashikohet të shpenzohet për kryerjen e një punimi
		12. Rregulloj kompjuterat
		13. Mbikëqyr/supervizoj ndërtimin e godinave
		14. Shkruaj një artikull shkencor (një punim i bazuar në të dhëna të mbledhura)
		15. Gdhend një skulpturë
		16. Ndhimoj fëmijët që kanë vështirësi apo probleme për të mësuar
		17. Intervistoj njerëzit për studime/sondazhe të ndryshme
		18. Menaxhoj një zyrë
		19. Mbjaj dhe dokumentoj dokumentat financiarë të një zyre
		20. Menaxhoj një stacion të energjisë elektrike
		21. Dizenjoj sisteme elektronike
		22. Jap mësim lëndë shkencore të tilla si biologji, kimi, fizikë etj.
		23. Pikturoj një portret
		24. Studioj mënyrën se si sillen njerëzit
		25. I shes rroba të tjerëve
		26. Menaxhoj shitjet
		27. Përgatis raporte të ndryshme sigurimesh (p.sh. sigurim jete, shëndeti, makine, banese etj)
		28. Hartoj programe kompjuterike për biznese të ndryshme
		29. Riparoj aeroplanë
		30. Vizatoj/skicoj ilustrime të anatomisë së trupit
		31. Shkruaj skenarin e një shfaqjeje teatrale



		32. Mësoj njerëzit si të kërcejnë
		33. Shoqëroj njerëzit në një studio televizive
		34. Organizoj/sistemoj dokumentacionin e zyrës
		35. Mbaj evidencat për shitjet e aksioneve
		36. Hartoj programe kompjuterike
		37. Kontrollonj kantieret e ndërtimit për sigurinë
		38. Vizatoj/skicoj yjet (kostelacione apo objekte astronomike)
		39. Vizatoj skica/kartona të animuara
		40. Mësoj të tjerët si të gatujnë
		41. Bëj paketim dhuratash në dyqan
		42. Fotokopjoj dokumenta të ndryshme
		43. Përcaktoj procedurat e kontabilitetit (e llogarive) të një biznesi
		44. Shqyrtoj hartat topografike që përcaktojnë kufinj të pronave të ndryshme
		45. Bashkoj instrumenta optikë të saktësisë së lartë
		46. Studioj jetën e gjallesave të egra
		47. Shkruaj romane
		48. Kujdesem për fëmijët në një çerdhe
		49. Jap mësim/leksione për një grup të madh njerëzish
		50. Ngas një autobus
		51. Analizoj rezultatet e zgjedhjeve politike
		52. Ngarkoj-shkarkoj kamionë
		53. Hartoj programe të mbështetjes sociale
		54. Ngas një taks
		55. Mbroj njerëzit në gjykatë
		56. Lëmoj mobiljet e drurit me letër zmerile

# ANEKSI 3

## PËRLLOGARITJA E SHKALLËVE TË PGI

PGI - me 56 pohime

Më poshtë tregohen mënyra se si përlogariten rezultatet bruto për çdo shkallë (interesat, aftësitë).

1. Lehtësimi social=  $(i1 + i9 + i17 + i25 + i33 + i41)/6$
2. Menaxhimi=  $(i2 + i10 + i18 + i26 + i34 + i42)/6$
3. Detajet e biznesit=  $(i3 + i11 + i19 + i27 + i35 + i43)/6$
4. Procesimi i të dhënave=  $(i4 + i12 + i20 + i28 + i36 + i44)/6$
5. Mekanik=  $(i5 + i13 + i21 + i29 + i37 + i45)/6$
6. Natyra/Jashtë=  $(i6 + i14 + i22 + i30 + i38 + i46)/6$
7. Artistik =  $(i7 + i15 + i23 + i31 + i39 + i47)/6$
8. Ndihmues=  $(i8 + i16 + i24 + i32 + i40 + i48)/6$
9. Prestigji i Lartë =  $(i49 + i51 + i53 + i55)/4$
10. Prestigji i Ulët =  $(i50 + i52 + i54 + i56)/4$
11. Njerëz =  $.924 * (\text{Shkalla } 8 + \text{Shkalla } 1) + .383 * (\text{Shkalla } 2 + \text{Shkalla } 7)$
12. Gjëra =  $.924 * (\text{Shkalla } 4 + \text{Shkalla } 5) + .383 * (\text{Shkalla } 3 + \text{Shkalla } 6)$
13. Të dhëna =  $.924 * (\text{Shkalla } 2 + \text{Shkalla } 3) + .383 * (\text{Shkalla } 1 + \text{Shkalla } 4)$
14. Ide =  $.924 * (\text{Shkalla } 7 + \text{Shkalla } 6) + .383 * (\text{Shkalla } 5 + \text{Shkalla } 8)$
15. Realist = Shkalla 5
16. Investigativ = Shkalla 6
17. Artistik = Shkalla 7
18. Social =  $(2 * \text{Shkalla } 8 + \text{Shkalla } 1)/3$
19. Enterprising (Sipërmarrës) =  $(2 * \text{Shkalla } 2 + \text{Shkalla } 1)/3$
20. Conventional (Konvencional) =  $(2 * \text{Shkalla } 4 + \text{Shkalla } 3)/3$
21. Njerëz/Gjëra = Shkalla 11 - Shkalla 12
22. Ide/Të dhëna = Shkalla 14 - Shkalla 13
23. Prestigji = Shkalla 9 - Shkalla 10

# ANEKSI 4

## SHEMBUJ

### Shembull 1: vajzë, moshë 21 vjeç

Grafiku në formë rrethore më poshtë për tetë llojet e interesave bazë tregon se vajza është e orientuar më tepër drejt njerëzve me rezultatet më të larta të shkallët që kanë të bëjnë me Ndhmën (*Helping*) dhe Lehtësimin social (*Social facilitating*) - të dyja vlerat e T janë rreth 60. Vlera T e shkallës së saj Artistike është relativisht më e ulët, rreth 55. Shkalla që ka të bëjë me Biznesin (*Business detail*) është T=50. Shkallët e tjera janë të gjitha relativisht të ulëta. Kjo lloj prirjeje tregon në mënyrë të qartë parapëlqimin për aktivitete që përfshijnë njerëzit e tjerë. Edhe vektori demonstroi po këtë prirje, duke shkuar drejt Njerëzve dhe vetëm pak drejt pjesës që lidhet me Idetë.

Vajza nuk ka treguar ndonjë parapëlqim të dukshëm as për shkallët që lidhen me prestigjin e lartë dhe as për shkallët që lidhen me prestigjin e ulët, gjë që duket qartë nga rezultatet e T të tabelës në vazhdim (dhe për këtë arsye nuk janë paraqitur në rezultatet e testit). Po ashtu, nuk u vu re as edhe ndonjë dallim në përgjigjet e saj midis Interesave për aktivitetet dhe Kompetencës/Aftësisë së përceptuar për aktivitetet.




Fig. 7 Grafiku rrethor dhe vektori për shembullin 1 në lidhje me 8 shkallët bazë

## Rezultatet e PGI për shembullin 1

Vlerat-T				
Shkallët	Interesat	Interesat	Interesat	Aftësitë
	norma e përgjithshme	norma gjinia e njëjtë	norma e përgjithshme	norma e përgjithshme
<b>Shkallët sferike</b>				
Lehtësimi Social	57	50	57	56
Menaxhimi	50	52	50	46
Detaje biznesi	36	41	36	38
Procesim të dhënash	34	43	34	37
Mekanik	37	39	37	30
Natyrë/Jashtë	30	35	30	31
Artistik	58	51	58	54
Ndihmues	62	54	62	66
Prestigji i Lartë	51	50		
Prestigji i Ulët	48	49		
<b>6-tipat</b>				
Realist	37	39		
Investigativ	30	35		
Artistik	58	51		
Social	60	52		
Enterprising (Sipërmarrës)	50	54		
Konvensional	35	42		
<b>4-tipat</b>				
Njerëz	60	52		
Gjëra	34	44		
Të dhëna	41	45		
Ide	45	52		
<b>Dimensionet</b>				
Njerëz/Gjëra	67	65		
Ide/Të dhëna	48	49		
Prestigji	52	53		



**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Tracey, Terence J. G.

Inventari i matjes së interesave : manual udhëzues / Terence J. G.

Tracey ; përshtat. në shqip. Livia Nano, Eralda Zhilla, Nada Kallçiu.

- Tiranë : Dollonja, 2020

... f. ; ... cm.

Tit. origj.: Inventari i globit personal : personal globe inventory

ISBN 978-9928-4564-4-1

1.Profisioni; 2.Drejtimi profesional; 3.Aftësia; 4.Pyetje dhe përgjigje; 5.Manuale

331.54 (035)

37 .048 (035)



ISBN 978-9928-4564-4-1



9 789928 456441